



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 75

Prishtinë, më 23.5.2012, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MBPZHR dhe Ministri i MMPH.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 21.5.2012,
3. Iniciativa “Të pastrojmë Kosovën”.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.5.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 21.5.2012.

3. Çështje aktuale

Kryetari **Nait Hasani** falënderoi për pjesëmarrje dhe ftoi komisionin në konsultim për ditën e nesërme kur fillon aksioni i OJQ “Të pastrojmë Kosovën”. Ministri i MMPH falënderoi komisionin për bashkëngjitje në këtë aksion dhe sqaroi se këtij aksioni i bashkëngjiten edhe

Institucionet shtetërore. Më vonë ai njoftoi me shkresë zyrtare se komisioni ftohet nesër më 24 maj në lagjen DARDANIA në orën 9,30 (tek shkolla “Xhemajl Mustafa”) ku është caktuar lokacioni zyrtar për fillimin e iniciativës së cekur.

Kryetari kërkoi bashkëpunimin e MMPH me rastin e shqyrtimit të dy Projektligjeve për Parqet Nacionale, për çka do të organizohet vizita në Rugovë me ekspertët e caktuar të Komisionit dhe me mbështetjen e NDI. Të hënën mbahet mbledhja e rregullt i komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 10,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani